REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr.5752/1 Prot.

Tiranë, më 04.5.2026

URDHËR

Nr.25/1, datë 04/05/2026

"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË SË BIZNESIT TË ADMINISTRATËS DOGANORE SHQIPTARE (2026-2027)"

Në mbështetje të nenit 2, të ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, në zbatim të pikës 1(b)(i), të Pjesës VIII/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921, datë 29.12.2014 "Për personelin e administratës doganore", të ndryshuar, si dhe të pikës 3, nenit 54, të Urdhërit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 146, datë 07.05.2018 "Për miratimin e Rregullores së brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe të Rregullores së Brendshme "Mbi funksionimin e degëve doganore",

Me qëllim orientimin dhe drejtimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për periudhën kohore 2026-2027, në funksion të përmbushjes së misionit dhe realizimit të vizionit të saj,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Veprimit së Biznesit të Administratës Doganore Shqiptare (2026-2027), të miratuar me nr. 10385 prot., datë 21.06.2023.

2. Për çdo objektiv strategjik, ngrihen dhe funksionojnë Grupet Drejtuese për ndjekjen dhe zbatimin e aktiviteteve në zbatim të Planit të veprimit të Strategjisë së Biznesit të Administratës Doganore Shqiptare.

3. Grupi Drejtues përbëhet nga drejtorët e drejtorisë përgjegjëse për masat e përcaktuara në planin e veprimit dhe kryesohet nga drejtori i departamentit si më poshtë:

a) për objektivin strategjik I, Grupi Drejtues kryesohet nga Drejtori i Departamentit teknik;

b) për objektivin strategjik II, Grupi Drejtues kryesohet nga Drejtori i Departamentit teknik;

c) për objektivin strategjik III, Grupi Drejtues kryesohet nga Drejtori i Departamentit operativo-hetimor;

ç) për objektivin strategjik IV, Grupi Drejtues kryesohet nga Drejtori i Departamentit administativ;

d) për objektivin strategjik V, Grupi Drejtues kryesohet nga Drejtori i Departamentit teknik;

4. Grupi Drejtues kryen këto detyra:

a) të përcaktojë aktivitetet/veprimtaritë si dhe treguesit e matshëm që realizojnë masat e përcaktuara në planin e veprimit, personat përgjegjës për realizimin e tyre, si dhe afatet brenda të cilit duhen realizuar;

b) të mbikëqyrë progresin në realizimin e aktiviteteve dhe përmirësimin e mekanizmave të bashkërendimit;

c) Të udhëzojë Departamentetet/Drejtoritë me të cilat bashkëpunon në realizimin e aktiviteteve për implementimin në kohë dhe me cilësi të Planit të Veprimit;

ç) Të propozojë ndryshime të Planit të Aktiviteteve dhe të hartojë propozime specifike për rishikimin e planit të veprimeve në funksion të dinamikës së zbatimit të Strategjisë.

5. Çdo grup drejtues paraqet raport të detajuar për ecurinë e punës brenda datës 5 të muajit për veprimtarinë e kryer gjatë muajit paraardhës te Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm sipas Tabelës së Monitorimit (bashkëlidhur).

6. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohen të gjithë strukturat doganore, sipas fushave përkatëse.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Besmir Beja